

Dimensioni gjinor dhe socio-ekonomik i arsimit të teknikut bujqësor



Botues:

Education Reform Initiative of South Eastern Europe - ERI SEE

Dečanska 8a, 11000 Beograd, Serbi

www.erisee.org, office@erisee.org

Autor

Dr Dragan Stanojević

Redaktues

Ivana Živadinović, ERI SEE Sekretariat

Tina Šarić, ERI SEE Sekretariat

Për botuesin

Tina Šarić

Botimi

Beograd, Maj 2024

Përkthimi

Idioma

Deligradska 14, Beograd, Serbi, i

idioma.rs, office@idioma.rs

ISBN: 978-86-82886-01-3



Përmbajtja

Hyrje.....	4
I Dimensioni socio-ekonomik i arsimit të teknikut bujqësor mundësi të barabarta për të gjithë: pozita socio-ekonomike e nxënësve në VET.....	5
Masat (e buta) të nevojshme për shekullin e XXI.....	7
Aftësitë e komunikimit.....	8
Prezantimi publik.....	8
Ushtrim për dëgjimin aktiv	9
Ndërveprimi profesional	10
Përforcimi i vetëbesimit.....	11
Të menduarit kritik:	12
Rishqyrtimi kritik i burimeve	12
Ushtrimi për rishqyrtim kritik të burimeve profesionale	13
Ushtrimi për rishqyrtim kritik të informacioneve në internet	14
Puna në ekip.....	15
Lojë – më e mira dhe më e keqja	15
Zgjidhja e konflikteve	16
Aftësitë e menaxhimit të kohës	17
Aftësitë dixhitale	18
II Dimensioni gjinor i arsimit të teknikut/teknikes bujqësore	19
Termet kryesore.....	21
Pse është e rëndësishme të theksojmë lidhjen midis profesionit të bujqësisë dhe gjinisë?... ..	22
Jeta në klasë - disa këshilla pune.....	24
Thyerja e stereotipave gjinore	26
Ushtrimi mbi profesionet gjinore.....	27
Shembujt nga historia.....	27
Ushtrimi - Ora me kujdestarin e klasës.....	29
Gjinia dhe dhuna në shkollë	30
Këshillat gjatë zbatimit të mësimin për zvogëlimin e stereotipave gjinor dhe përjashtimit social	33
Ndërlidhja me kolegët dhe bashkëmoshatarët nga vendet e tjera	36
Literatura dhe burimet nga interneti	38

Hyrje

Udhëzuesi ***Dhe socio-ekonomik i arsimit të teknikut bujqësor*** u krijua në kuadër të projektit Përmirësimi i Cilësisë së Arsimit dhe të Trajnimeve në Evropën Juglindore - EQET SEE¹ të koordinuar nga Sekretariati i Nismës për Reformën e Arsimit në Evropën Juglindore (Sekretariati ERI SEE - <https://www.erisee.org/>). Projekti EQET SEE i ka bërë bashkë ekonomitë e Ballkanit Perëndimor, ndër të tjerave, me qëllim për të zhvilluar një standard rajonal të profesioneve² dhe standard rajonal të kualifikimeve³ si dhe materialet mësimore për teknik bujqësor të prodhimit tradicional dhe organik.

Në përputhje me udhëzuesin⁴ e publikuar nga donatori i cili mbështet projektin EQET SEE, Agjencia Austriake e Zhvillimit⁵, ky dokument synon të ofrojë mbështetje shtesë për mësuesit që do të zbatojnë programin e teknikut bujqësor të prodhimit tradicional dhe organik në nivelin kombëtar, duke marrë parasysh standardet e zhvilluara rajonale të profesioneve dhe kualifikimeve

Pjesa që ka të bëjë me këshillat për arritjen e barazisë gjinore është krijuar duke pasur parasysh standardet dhe përpjekjet e Kombeve të Bashkuara përmes programeve të fokusuara te barazia gjinore dhe fuqizimi i grave (Gender equality and the empowerment of women and girls - GEWE) me qëllim të arritjes së disa qëllimeve të zhvillimit të qëndrueshëm.

Dokumenti përbëhet nga dy pjesë: Pjesa e parë flet për aspektet socio-ekonomike të programit të teknikut bujqësor, ndërsa e dyta u referohet aspekteve gjinore të programit të teknikut bujqësor.

Autor

Dr Dragan Stanojević⁶

¹ E aksesueshme në: <https://eqet.erisee.org/> e qasur më 11.1.2023

² Standardi i profesionit mund të gjendet në: <https://eqet.erisee.org/occupational-standards/> e qasur më 11.1.2023.

³ Standardi i kualifikimit mund të gjendet në: <https://eqet.erisee.org/qualification-standards/> e qasur më 11.1.2023.

⁴ Manual Environmental, Gender and Social Impact Management https://www.entwicklung.at/fileadmin/user_upload/Dokumente/Publikationen/Handbuecher/Environmental_and_Social_Impact_Management/EGSIM_Manual_Juni2018.pdf

⁵ E aksesueshme në: <https://www.entwicklung.at/> e qasur më 11.1.2023.

⁶ Autori është docent na Fakultetin Filozofik të Universitetit të Beogradit. Kontakt: draganstanojevich@gmail.com

I Dimensioni socio-ekonomik i arsimit të teknikut bujqësor mundësi të barabarta për të gjithë: pozita socio-ekonomike e nxënësve në VET



Barazia – niset nga supozimi që i njëjti lloj mbështetjeje i ndihmon njësoj të gjithë



Nivelim – secili merr mbështetjeje që i nevojitet



Drejtësi – heqja e barrierave që çojnë në pabarazi

Burimi: [web faqja](#)⁷

Pabarazitë socio-ekonomike të lidhura me arsimin e mesëm profesional dhe trajnimet (VET⁸) mund të vështrohen në dy mënyra:

1. si **pabarazia e qasjes në arsim të mesëm**, ku fëmijët nga familjet e varfra dhe shtresat më të ulëta më shpesh zgjedhin shkolla të mesme profesionale sepse prindërit parashikojnë se nuk do të kenë mundësi të mjaftueshme që t'u sigurojnë shkollim gjatë arsimit të lart. Kjo formë pabarazie mund të adresohet duke përafuar të gjitha përmbajtjet relevante që mund të mësohen dhe në shkolla të tjera të mesme, në nivelet më të larta të arsimit, si dhe përmes arsimit joformal dhe sidomos përmes zhvillimit të *aftësive të buta*. Në këtë mënyrë nxënësit në sistemin e arsimit të mesëm profesional do të mësojnë të gjitha aftësitë relevante të cilat mund t'i ndihmojnë gjatë punësimit, në arritjen e rezultateve të mira, në komunikim me kolegët dhe partnerët, gjatë punës në ekip, në lidhje me mbështetjen institucionale, dhe për ngritjen e biznesit të vet për disa prej tyre.

⁷ E aksesueshme në: <https://www.mobilizegreen.org/blog/2018/9/30/environmental-equity-vs-environmental-justice-whats-the-difference>, e qasur më 14.5.2023.

⁸ Akronimi do të thotë *vocational education and training* - VET.



2. si **pabarazi midis nxënësve** në sistemin e arsimit të mesëm profesional, që u referohet dallimeve në pozitën socio-ekonomike e cila mund të ndihmojë tek sukcesi i nxënësit gjatë dhe pas arsimit. Pabarazi e pranishme midis nxënësve në shkollë mund të zgjidhet duke ofruar mbështetje të përshtatshme për fëmijën në raport me nevojat specifike që ka. Fëmijët që vijnë nga familjet ku prindërit kanë arsim të ulët që në hyrje të arsimit të mesëm hasin sfidën e përshtatjes me përmbajtjen arsimore dhe përballimin e saj në mënyrë adekuate. Është e rëndësishme të fillojmë herët me mbështetjen në integrim përmes përkrahjes së përshtatshme nga ana e mësuesve dhe moshatarëve.

Përveç kësaj, është e nevojshme të vihen në dispozicion informacionet mbi programet e mbështetjes institucionale, siç janë kredi dhe bursa, si dhe orientimi në karrierë në nivel shkolle.

Masat (e buta) të nevojshme për shekullin e XXI

Edhe pse është supozim i përgjithshëm që VET duhet të mundësojë përfitimin e njohurive dhe aftësive konkrete dhe orientimin e drejtpërdrejtë të nxënësve në botën e punës, duhet theksuar që zhvillimi i teknologjive të reja, fleksibilizimi i sferës së punës dhe globalizimi i ekonomisë sjellin nevojën për disa aftësi të cilat po zhvillohen në mënyrë sporadike gjatë arsimit të mesëm, të ashtuquajtura aftësi të buta. Aftësitë e buta i referohen një grupi karakteristikash personale dhe shoqërore të cilat i mundësojnë individit që të komunikojë në mënyrë efikase, të ndërveprojë me të tjerët dhe të përballojë me sukses situata të ndryshme shoqërore dhe profesionale.

Aftësitë e buta më shpesh përfshijnë:

Aftësitë e komunikimit: Aftësia për të transmetuar ide dhe informacione në mënyrë efikase, qoftë me gojë ose shkrim. Ajo përfshin edhe aftësinë për të ndërtuar raporte pozitive në mënyrë që ndërveprimi me të tjerët të zhvillohet në mënyrë produktive dhe me respekt reciprok.

Aftësitë e negociimit: Aftësia për të arritur marrëveshje me dobi reciproke përmes komunikimit efikas dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.

Të menduarit kritik: Aftësia për të analizuar dhe vlerësuar informacionet me kujdes, me qëllim të formimit të mendimit dhe të marrjes së vendimeve të bazuara dhe praktike.

Puna në ekip: Aftësia për të bashkëpunuar me të tjerët dhe për të kontribuar në suksesin e ekipit.

Aftësitë e zgjidhjes së problemeve: Aftësia për të analizuar dhe zgjidhur çështjet komplekse.

Aftësia e menaxhimit të kohës: Aftësia për planifikuar detyrat në mënyrë efikase me qëllim që të arrihet qëllimi.

Përshtatshmëria: Aftësia për t'iu përshtatur rrethanave të reja dhe ambientit që ndryshohet.

Aftësitë dixhitale: Aftësia për të përdorur mjetet dixhitale në mënyrë efikase.

Në vazhdim do të japim disa ushtrime për zhvillimin e disa prej aftësive të lartpërmendura.

Aftësitë e komunikimit

Komunikimi efikas është një aftësi shumë e rëndësishme në botën bashkëkohore e cila bazohet mbi vlerat e shoqërisë qytetare (të drejtat e barabarta, respekti reciprok, toleranca) dhe një aftësi e butë që vlerësohet shumë nga punëdhënësit sepse nxit bashkëpunim dhe frymën e ekipit. Për t'i ndihmuar nxënësit që të zhvillojnë aftësitë e komunikimit, mund t'u caktoni detyra të cilat i ndihmojnë që të ushtrojnë prezantimin e ideve para të tjerëve, dhe të zhvillojnë dëgjimin aktiv dhe komunikimin profesional.

Prezantimi publik

Aftësia e të prezantuarit para të tjerëve mund të ndërtohet dhe përmirësohet përmes aktiviteteve siç janë prezantimi i projekteve kërkimore para klasës (prezantimet publike), nxitja e dëgjimit aktiv dhe pyetjet konstruktive nga ana e moshatarëve. Për shembull, nga një nxënës në çdo orë mund të prezantojë punën e tij në lidhje me njërën prej temave relevante të lëndës, nëpërmjet prezantimit (për shembull *power point*). Për t'u bërë efikas, gjerat më të rëndësishme duhet të theksohen në mënyrë të qartë dhe interesante. Prezantimi duhet të zgjasë nga 5 deri në 10 minuta, të ketë nga 3 deri në 10 slajde, dhe mundësisht të përfshijë figura ose video material të shkurtër, përveç tekstit. Qëllimi i prezantimit është paraqitja e ideve kryesore para klasës në mënyrë të përmbledhur dhe koncize. Gjatë dhe pas prezantimit, nxënësit e tjerë duhet të bëjnë pyetje nëse diçka u duket e paqartë, ose nëse kanë shembuj të tjerë që mbështesin ose i kundërshtohen asaj që u prezantua. Për më tepër, mund t'i ndani nxënësit në grupe dhe t'u caktoni detyrë që të gjejnë shembuj në internet për tematikën për të cilën flitet. Më pas mund të nxitet debati për zgjidhjet më të mira dhe më të këqija për kontekstin e caktuar.



Ushtrim për dëgjimin aktiv

1 Ushtrimi: Forma e komunikimit midis nxënësve, por edhe me mësuesit gjatë orës së mësimit, mund të jetë e formuar nga kultura e komunikimit e cila nënkupton prirjen për t'u treguar, për të sfiduar autoritetin ose për të ndërprerë bashkëbiseduesin. Ky ushtrim synon të ofrojë një mënyrë tjetër të komunikimit, e cila bazohet mbi respektin reciprok midis bashkëbiseduesve dhe dëgjimin aktiv, si formë e komunikimit e cila gjithnjë e më shumë karakterizon botën bashkëkohore (sidomos komunikimi i biznesit dhe puna në ekip).

Shpjegoni dëgjimin aktiv para nxënësve. Dëgjimi aktiv është mënyra e pjesëmarrjes në komunikim me të tjerët ku synojmë të kuptojmë plotësisht mesazhin e bashkëbiseduesit, si atë verbal (atë që thuhet) ashtu dhe atë joverbal (si thuhet diçka, dhe si ndihen teksa flasim). Nëse e kuptojmë mirë se çka ka dashur të thotë bashkëbiseduesi, do të shmangim mosmarrëveshjet dhe reagimet e padëshiruara. Në këtë mënyrë shprehim respekt dhe interesim për atë që po na komunikohet dhe përforcojmë mirëbesimin reciprok.

Ka disa këshilla se çfarë duhet të kenë parasysh nxënësit gjatë komunikimit: a) merrni qëndrim miqësor ndaj bashkëbiseduesit, b) mos e ndërprisni bashkëbiseduesin kur flet, c) pyesni nëse keni diçka të paqartë, d) provoni të bëni përmbledhje të gjërave të rëndësishme në bisedë (cilat janë konkluzionet e bisedës).

Ndani nxënësit në çifte (ndarjen duhet ta bëjë mësuesi në mënyrë që të shmangë grupimin e atyre që shoqërohen në mënyrë intensive) dhe caktoni detyrat në vijim. Çdo çift mund të bëjë njërin nga skenarët në vijim, ose të gjejnë ndonjë temë që u duket interesante. Qëllimi është që njëri nxënës të flasë, dhe tjetri ta dëgjojë në mënyrë aktive.

1. Skenari - praktika e nxënësve. Nxënësi i shpjegon shokut të klasës se cilat janë sfidat gjatë zbatimit të praktikës së nxënësve. Sfidat përfshijnë probleme me mësuesit ose instruktorët, me përmbajtjen, detyrat në praktikë, me interesimet personale.
2. skenari – sfidat në klasë. Nxënësi i shpjegon shokut të klasës se çfarë problemesh has me shokët, çfarë mendon ai për këtë dhe si ndihet. Kjo mund të përfshijë konfliktet, mosmarrëveshjet, shmangiet, pëlqimet dhe mospëlqimet.
3. skenari – marrëdhënia me mësuesit. Nxënësi i shpjegon shokut të klasës se si përjeton marrëdhëniet me mësuesit në shkollë. A janë mësuesit profesionalë, të ftohtë, të distancuar, apo janë të gatshëm për të ndihmuar etj.
4. skenari - planet për të ardhmen. Nxënësi i tregon shokut të klasës se çfarë planesh ka për të ardhmen nga pikëpamja e profesionit, vendbanimit të preferuar, martesës, familjes, hobi që do të donte të kishte etj.

Ai që dëgjon duhet të mbetet i fokusuar tek biseda, të bëjë pyetje nëse ka diçka të paqartë, të mos e ndërpresë bashkëbiseduesin dhe të mos japë mendimin e tij teksa flet bashkëbiseduesi, të mos gjykojë por të përpiqet të kuptojë se si dhe pse ndihet kështu bashkëbiseduesi kur flet për temën në fjalë. Në fund të bisedës të dy bashkëbisedues mund të kalojnë nëpër tema kyçe dhe



të përmbledhin atë që ka dashur të thoshte bashkëbiseduesi i parë. Pas përfundimit të ushtrimit bisedoni me nxënësit në lidhje me ecurinë e bisedës. Çka ka qenë sfiduese për ta në një proces të tillë të të dëgjuarit dhe të folurit? A mund të ndajnë disa këshilla me të tjerët?

Ndërveprimi profesional

Një numër i konsiderueshëm nxënësish do të punojnë drejtpërdrejtë me klientët pasi të mbarojnë shkollën e mesme. Në mënyrë që marrëdhënia të jetë korrekte dhe profesionale, por edhe e këndshme dhe me kënaqësi reciproke, ekzistojnë disa aftësi komunikimi të cilat mund të mësohen në shkollë dhe mund të ushtrohen gjatë praktikës.

Shembull:

Caktoni detyrën në vijim për nxënësit. Në orën 5.30 marrin telefonatë nga një grua e cila po pyet nëse mund të vini menjëherë që të shihni se çfarë nuk është në rregull me një kafshë që po sillet çuditshëm. Ajo po u shpjegon që sapo ishte nisur për në punë dhe se sa kishte dalë nga shtëpia, kishte konstatuar se kafsha nuk është mirë. Gruaja duket shumë e shqetësuar sepse po nxitohet për të shkuar në punë por fillimisht duhet të çojë fëmijën në kopsht.

Pyetja për nxënësit, si do të vepronit në një situatë të tillë? Ndani nxënësit në çifte ku njëri nxënës do të luajë rolin e klientes dhe tjetri të veterinerit. Le të përshkruajnë me detaje ecurinë e bisedës. A do të zhvillohej ndryshe biseda po të ishte një burrë në telefon? Pse?

Gjatë diskutimit mund të jepni këshilla si vijon:

Toni i bisedës: Me zë të qetë dhe bindës komunikoni me klienten. Proveni ta qetësoni dhe t'i shpjegoni që situatat e tilla ndodhin. Mos bëni shaka në lidhje me situatën.

Jini të sinqertë në lidhje me kohën: Shpjegojini klientes se sa kohë do t'ju duhet për të arritur tek ajo dhe për të kryer punën.

Jini të sinqertë në lidhje me çmimin e shërbimit: Bëni një vlerësim të kostos së shërbimit dhe të opsioneve të pagesës nga klientja .

Kontakti i parë me klienten: Përhëndesni klienten me mirësjellje gjatë takimit. Mund t'ia jepni dorën nëse kjo është diçka e zakonshme. Prezantohuni me emër dhe mbiemër, nga e cila kompani vini dhe thoni arsyen pse keni ardhur.

Komunikimi me klienten: Bëni pyetje në lidhje me arsyen e angazhimit tuaj. Kërkoni të gjitha informacionet e duhura që në fillim të punës. Dëgjoni në mënyrë aktive se çfarë po thotë klientja . Mos e gjykoni klienten nëse ajo nuk ka njohuri të mjaftueshme nga fusha juaj, ose nëse bën gabime me kafshët nga ekspertiza juaj. Në fund pyesni klienten nëse është e kënaqur dhe nëse ka ndonjë pyetje shtesë në lidhje me kafshën në fjalë⁹.

⁹ E aksesueshme në: <https://www.locksmithjournal.co.uk/locksmiths-clients-importance-clear-communication>, e qasur më 10.5.2023.



Afërsia dhe distanca: Biseda duhet të ketë një ton profesional dhe të këndshëm. Klientes duhet t'i drejtohem me "Ju" për të ruajtur marrëdhënien profesionale e cila ju mbron nga keqpërdorimi potencial.

Gjinia: Nëse klienti është grua, nuk do të ishte e përshtatshme që të riprodhohmë stereotipat gjinore me komente të tipit: "kjo u ndodh vetëm grave", "gratë harrojnë më shumë" etj. Nuk duhet të bëjmë dallim në bazë të gjinisë në qasje ndaj klientit.

Përforcimi i vetëbesimit

Ushtrimi bëhet në grupe të vogla me nga 4-5 nxënës. Çdo person në grup do të jetë në fokusin e grupit në një moment. Nxënësit mund të formojnë një rreth ku një person do të ulet në qendër të rrethit.

1. Ajo ose ajo përshkruajnë ngjarjen në të cilën kanë arritur diçka ose janë ndjerë mirë. Nuk është e thënë të ketë lidhje me punën. Të tjerët dëgjojnë me vëmendje.
2. Çdo anëtar i grupit duhet të thotë dy ose tre aftësi që ka përdorur për të arritur atë. Personi shton një ose dy aftësi të veta.
3. Personi thotë një aftësi që i ka pëlqyer më shumë nga të gjitha të tjerat. Nxënësi çohet në këmbë, i afrohet çdo personi dhe i thotë secilit me radhë "Unë jam (p.sh.) i shkathët!".
4. Mësuesi mund ta nxisë atë duke e inkurajuar që të përdorë një ton të qartë dhe pozitiv të zërit dhe të qëndrojë me vetëbesim.
5. Pasi t'u kalojë radha të gjithëve, pyesni nxënësit se si ndihen dhe çfarë kanë mësuar.¹⁰

¹⁰ E aksesueshme në: <https://www.sessionlab.com/methods/strength-building-exercise> e qasur më 16.4.2023.

Të menduarit kritik:

Rishqyrtimi kritik i burimeve

Interneti ka shumë burime të ndryshme për tema shumë të ndryshme. Faqe të ndryshme interneti, rrjetet sociale, gazeta, blogje individësh, mund të kenë qëndrime plotësisht të njëjta ose të ndryshme për temat në fjalë. Qoftë kur bëhet fjalë për kërkimin e teksteve profesionale ose për lajmet që kanë të bëjnë me ngjarjet shoqërore, është shumë e rëndësishme se cilat burime informacionesh përdoren, sepse disa prej tyre mund të japin informacione të gabuara dhe disa të tjera mund të provojnë të nxjerrin diçka nga ju (paratë, vëmendjen etj.).

Gjatë kërkimit të internetit për një temë të caktuar, kur një lajm ose informacion ju duket ekstrem (shumë i mirë apo shumë i keq), kontrolloni si më poshtë:

1. Kontrolloni nëse i njëjti informacion apo lajm gjendet ne faqe dhe portale të tjera
2. Verifikoni besueshmërinë e burimit. Sipas besueshmërisë, burimet mund të kategorizohen si:
 - a. *Burimet shkencore dhe profesionale.* Libra, artikuj, raporte të shkruara nga shkencëtarët dhe ekspertët e fushës. Për burimet nga pikëpamja e profesionit, për shembull në lidhje me materialet e ndryshme dhe mënyrat e përpunimit të tyre, ajo që shkruhet ose thuhet nga profesorët e fakultetit, shkencëtarët e institutit, inxhinierit e fabrikave me shumë mundësi është më relevante dhe me e saktë.
 - b. *Rregulloret dhe standardet e institucioneve zyrtare.* Rregulloret dhe standardet miratohen nga organet dhe institucionet shtetërore që garantojnë cilësi të proceseve dhe produkteve të punës. Ato mund t'i gjeni në faqet e institucioneve zyrtare, Qeverisë, ministrive, kompanive.
 - c. *Tekstet shkollore.* Tekstet shkollore kalojnë procesin e recensimit dhe verifikimit të informacioneve të përmbajtura në to, dhe mund të jenë burim shumë i mirë për shumë pyetje. Patjetër, duhet t'u japim përparësi teksteve më të reja sepse ato përmbajnë arritjet më të reja të shkencës dhe profesionit.
 - d. *Standardet e materialeve dhe standardet e përdorimit të makinave.* Me qëllim të kryerjes profesionale të punëve janë më relevante materialet që parashikojnë standardet e materialeve, përpunimit të tyre dhe mënyrat e përdorimit të makinave që i përpunojnë ato. Këto burime përkufizohen më shpesh nga prodhuesit në përputhje me standardet e përgjithshme të sigurisë.
 - e. *Portalet e gazetave.* Edhe pse etika e gazetarisë parashikon paanësi gjatë raportimit, vihet re që jo të gjitha gazetat dhe gazetarët i përmbahen këtij standardi. Prandaj është shumë e rëndësishme tek gazetatat që të mbështetemi tek burimet të cilat synojnë të raportojnë në mënyrë objektive dhe të paanshme për një temë të caktuar. Për të verifikuar besueshmërinë e agjencisë

ose gazetarit, mund të kontrolloni nëse media/gazetari është dënuar ndonjëherë për mosrespektim të standardeve profesionale. Gjithashtu, verifikoni lajmin në portale të tjera dhe krahasoni mënyrën se si raportohet për të. Nëse lajmi ju imponon një mënyrë të caktuar të të menduarit (që të blini një produkt, urrejtje, miratim, gjykim) kini kujdes dhe kontrolloni të njëjtën në disa vende.

- f. *Rrjetet sociale* Rrjetet sociale përmbajnë një sërë informacionesh të ndryshme: Vërejtje dhe qëndrime personale, lajme gazetash, reklama të kompanive, komunikime të institucioneve, por edhe qëndrime dhe mendime të grupeve të ndryshme shoqërore (lëvizje, parti, organizata rinore etj.). Gjatë verifikimit të saktësisë së këtyre informacioneve, duhet të jemi të vetëdijshëm se kush qëndron pas tyre. Më pak të besueshëm (edhe pse nuk duhen refuzuar) janë mendimet dhe qëndrimet e individëve.

Ushtrimi për rishqyrtim kritik të burimeve profesionale

Nxënësit duhet të kenë letër dhe laps, qasje në internet, mundësisht të kenë edhe PC ose laptop. Zgjidhni njërën nga temat që trajtoni në mësim, e cila mund të jetë e përshtatshme për kërkim të materialeve dhe standardeve të reja. Përgatitni tre lojë materialesh: Rregulloren e njëres prej institucioneve zyrtare (për shembull standardet e saldimit), standardin e njëres prej kompanive që prodhojnë materiale ose makina, dhe përvojat personale të ekspertëve/ustallarëve.

Pastaj hapni diskutim (5 minuta) për burimet e informacioneve, si formohen ato, kush i miraton dhe çfarë kredibiliteti kanë ato informacione.

Ndajini në grupe me nga 3-4 nxënës. Le të bëjnë kërkim në të gjitha burimet e lidhura me temën (10 minuta). Duhet t'i klasifikojnë sipas skemës së mësipërme (5 minuta). Pastaj duhet të kalojnë aspektet e vlerësimit të burimeve si më poshtë: a) kush është autor, b) cili është qëllimi i këtij burimi, c) sa i detajuar është përshkrimi ose shpjegimi i burimit, d) kur është krijuar burimi (10 minuta). Në bazë të këtij vlerësimi duhet të bëjnë një hierarki të relevancës së burimeve (5 minuta). Pas kësaj, çdo grup duhet të prezantojnë rezultatet shkurtimisht ndërsa nxënësit nga grupet e tjera mund t'u bëjnë pyetje dhe të japin komente.



Ushtrimi për rishqyrtim kritik të informacioneve në internet

Nxënësit duhet të kenë letër dhe laps, qasje në internet, PC, laptop ose tablet. Në fillim të orës së mësimi bini dakord që në ushtrimin e radhës do të merreni me burimet e informacioneve dhe besueshmërinë e tyre. Pyetini se ku informohen për gjërat e rëndësishme që kanë edhe relevancë shoqërore (përfshijeni informacione të cilat u referohen atyre personalisht ose rrjeteve të tyre të miqve dhe të njohurve). Bëni një listë të burimeve të paraqitura nga nxënësit në anën e majtë të dërrasës. Pastaj u prezantoni dhe burimet e tjera të cilat do të listoni në anën e djathtë të dërrasës.

Pyetini se çfarë u ka lënë përshtypje së fundmi në lidhje me temat shoqërore. Shënoni disa tema kyçe në dërrasë dhe pyetini se ku janë informuar mbi këtë temë.

Ndajini në grupe me nga 3-4 nxënës. Çdo grup duhet të zgjedhë njërin nga lajmet/temat që u ka tërhequr vëmendje së fundmi. Çdo grup duhet të niset nga burimet që kanë përdorur për herë të parë dhe të përshkruajnë se çfarë po na porosit lajmi. Pastaj duhet të verifikojnë të njëjtin lajm në burimet e tjera: a) faqet zyrtare të institucioneve (në varësi nga tema p.sh. te faqja e ministrisë, MPB-së, Institucionit shëndetësor etj.), b) agjenci të tjera të lajmeve.

Çdo grup duhet të verifikojë çdo burim: a) kush është autor, b) kur u krijua burimi, c) sa i detajuar është përshkrimi / shpjegimi i burimit, d) a synon burimi të shkaktojë reagim të fortë emocional (acarim, inat, etj.), e) sa i besueshëm është burimi (a është dënuar ndonjëherë agjencia për mosrespektim të standardeve profesionale). Në bazë të këtij vlerësimi ekipet duhet të bëjnë një hierarki të relevancës së burimeve. Pas kësaj, çdo grup duhet të prezantojnë rezultatet shkurtimisht ndërsa nxënësit nga grupet e tjera mund t'u bëjnë pyetje dhe të japin komente.

Puna në ekip



Një nga mënyrat për t'u ofruar nxënësve mundësi që të ushtrojnë dhe përmirësojnë punën në ekip, zgjidhjen e problemeve dhe aftësitë e lidërshpit, është caktimi i detyrave në grup nga mësuesi. Projekti i përbashkët kërkon nga ata që të ndajnë detyrat, të punojnë bashkërisht dhe të bien dakord me njëri-tjetrin dhe të koordinojnë aktivitetet.

Ja disa mënyra se si mund ta bëni mësimin më interesant dhe nxënësit të përfshihen më shumë, kurse shembuj të tjerë mund të gjeni në web faqen [sessionlab](https://www.sessionlab.com).¹¹

Lojë – më e mira dhe më e keqja

Edhe pse nxënësit njihen me njëri-tjetrin sepse janë në një klasë, ata rrallë kanë mundësi të bisedojnë së bashku për përvojat dhe prirjet e tyre. Ky ushtrim mund t'i ndihmojë që të njihen akoma më mirë, të flasin për veten në grup dhe të dëgjojnë të tjerët. Çdo nxënës duhet të përgatisë dy copë letër dhe të ketë një laps. Mësuesi u jep udhëzime të gjithëve: Secili duhet të shkruajë një pyetje për gjënë më të mirë dhe një pyetje për gjënë më të keqe që dëshiron të mësojë për të tjerët. Për shembull, për gjënë më të mirë nxënësi mund të bëjë pyetje në vijim: „Sa ke vrapuar më shpejt?“, „Cilën ditëlindje e mban mend më mirë dhe pse?“, „Kë ke shok/shoqe më të ngushtë?“. Pyetjet që shprehin gjërat jo dhe aq të mira mund të si më poshtë: „Kur je ndjerë më i trishtuar në shkollë dhe pse?“, „Cili ka qenë pikniku ose udhëtimi më i keq që ke bërë ndonjëherë?“, ose „Cilën lëndë e ke më të vështirë?“.

Nxënësit më pas vendosin letrat në banka duke i ndarë në dy grupe: 1. Pyetjet për gjënë më të mirë dhe 2. Pyetjet për gjënë jo të mirë. Më pas nxënësit dalin dhe marrin nga një letër nga tufa (por jo atë që kanë lënë vetë, rëndësi ka të marrin një që nuk ia dinë autorin) dhe u përgjigjen pyetjeve.

Mësuesit duhet të mundësojnë që nxënësit të ndihen të sigurt dhe që secili prej tyre të mund të shprehet pa pasur frikë nga gjykimi prej të tjerëve. Mësuesi mund të kontrollojë pyetjet teksa po lihen në tufë, për t'u siguruar që të mos ketë përmbajtje ofenduese.¹²

¹¹ E aksesueshme në: <https://www.sessionlab.com/methods/strength-building-exercise> e qasur më 6.5.2023.

¹² E aksesueshme në: <https://www.sessionlab.com/methods/best-and-worst>, e qasur më 6.5.2023.

Zgjidhja e konflikteve

Ky aktivitet mund të zbatohet gjatë orës me kujdestarin e klasës, me qëllim që të zgjidhen konfliktet aktuale ose të parandalohen konfliktet e ardhshme, duke i aftësuar nxënësit për zgjidhje konfliktesh.

Hapi 1: Kërkoni nga nxënësit që të mendojnë për konfliktet që kanë hasur deri tani, qoftë individuale ose në njërin nga grupet. Këto konflikte mund të jenë pjesë e marrëdhënieve midis nxënësve në klasë, por edhe në grupet e tjera ku ata bëjnë pjesë, siç janë klubet sportive, grupet joformale etj. Çdo nxënës duhet të identifikojë për veten e vetë sa më shumë konflikte, duke përfshirë edhe vitet e mëparshme nëse është e nevojshme. Secili duhet të kujtojë një konflikt individual dhe ta vlerësojë atë në fletore: 1 = Konflikti që kam zgjidhur mirë, 2 = Konflikti që kam zgjidhur pjesërisht, 3 = Konflikti që kam zgjidhur keq.

Hapi 2: Kërkoni nga nxënësit që të mendojnë veç e veç, dhe më pas të bisedojnë në çift ose nga tre veta në grup për pyetjet në vijim: Si ishin reagimet gjatë konfliktit? Cilat sjellje u treguan efikase në zgjidhjen e konfliktit? Cilat sjellje u treguan joefikase në zgjidhjen e konfliktit?

Hapi 3: Në bazë të debatit në grupe të vogla, kërkoni nga secili që të hartojë nga 2-3 udhëzime për zgjidhjen efikase të konflikteve, të cilat duhet të respektohen nga e gjithë klasa në rast të ndonjë konflikti. Kërkoni nga secili që të ndajë udhëzimet e tij me grupin dhe bini dakord për një listë udhëzimesh të cilat do t'i ndjekë e gjithë klasa.¹³

¹³ E aksesueshme në: <https://www.sessionlab.com/methods/conflict-responses> e qasur më 6.5.2023.

Aftësitë e menaxhimit të kohës

Ky aktivitet është një debat që bëhet në grupe të vogla me qëllim që nxënësit të mësojnë se si të menaxhojnë kohën duke mësuar të vendosin prioritete.

1. Ndani nxënësit në grupe nga 4 deri 5 persona dhe jepini çdo grupi nga një letër dhe lapsa me ngjyrë.
2. Caktoni 15 minuta kohë që të bëjnë një listë detyrash të cilat mund të jenë pjesë e detyrës së shtëpisë ose të praktikës gjatë mësimit praktik. Për shembull, si organizohet përgatitja e materialeve, makinave dhe zbatimi i punimeve (për shembull).
3. Kërkoni nga nxënësit që t'i japin prioritet çdo detyre individuale në bazë të rëndësisë së çdo detyre.
4. Në fund kërkoni nga anëtarët e grupit që të japin feedback për pjesën tjetër të klasës dhe pyetini: „Cilat detyra i konsideruat si më të rëndësishme dhe pse?“
5. Diskutimi do të ketë të bëjë me detyrat e rëndësishme dhe si ta dimë ne që janë të rëndësishme.¹⁴



¹⁴ E aksesueshme në: <https://symondsresearch.com/time-management-activities/> e qasur më 16.4.2023.

Aftësitë dixhitale

Duke qenë se teknologjia po bëhet gjithnjë e më e pranishme në jetën tonë të përditshme, edhe aftësitë dixhitale po marrin gjithnjë e më shumë rëndësi. Këto aftësi mund të përmirësojnë produktivitetin dhe efikasitetin e individëve në jetën e tyre personale dhe profesionale, por edhe mund të hapin mundësi të reja për karrierën. Shembujt e aftësive dixhitale përfshijnë punë me kompjuter dhe përdorim të softuerit, përdorim interneti dhe të instrumenteve të ndryshme *online*, si dhe përdorimin e rrjeteve sociale dhe të platformave të tjera dixhitale për komunikim dhe bashkëpunim etj. Përveç kësaj, aftësitë dixhitale mund të ndihmojnë individët që të ndjekin përparimin teknologjik dhe të përshtaten me zhvillimin e teknologjive të reja.

Për të ndihmuar nxënësit që të zhvillojnë aftësitë dixhitale mund të bëni diçka nga më poshtë:

1. Një nga detyrat mund të jetë që të gjejnë në internet burimet video për mënyrat e përpunimit të metaleve për të cilat janë duke mësuar.
2. Caktoni detyrë shtëpie që të bëjnë një skedar tekstual (për shembull në formatin *.doc*) dhe t'jua dërgojnë atë më e-mail. Në këtë mënyrë ata do të mësojnë të formatojnë tekstin por edhe të përpilojnë dhe të dërgojnë postë elektronike.
3. Disa nga detyrat mund t'i strukturoni në mënyrë që të përfshijnë prezantime që nxënësit do të prezantojnë para klasës në mënyrë të pavarur ose në grup. Prezantimet duhet të përfshijnë tekst, figura, si dhe materialet audio dhe video.
4. Kërkoni nga nxënësit që të konsultojnë burimet e ndryshme në internet gjatë përgatitjes për mësim. Në këtë mënyrë do të mësojnë të kërkojnë burime të ndryshme por edhe të bëjnë vlerësim kritik të vlefshmërisë së tyre.
5. Ndihmohjini nxënësit që të gjejnë aplikacione të dobishme për mësim dhe nxitini që t'i kërkojnë vetë dhe t'i përdorin. Ka shumë platforma dhe kanale që përmbajnë njohuri të vlefshme.¹⁵



¹⁵ E aksesueshme në: <https://www.unicef.org/serbia/otvoreni-obrazovni-digitalni-alati-za-interaktivnu-nastavu-i-ucenje-preko-interneta> e qasur më 10.6.2023.

II Dimensioni gjinor i arsimit të teknikut/teknikes bujqësore

Tekniku bujqësor dhe teknikja bujqësore janë një profesion i cili (mund) të ushtrohet njësoj nga burrat dhe gratë.



Sot kur flitet për barazinë gjinore, nuk shtrohet më pyetja nëse ajo është e nevojshme apo jo, por si mund ta arrijmë atë? Kombet e Bashkuara po bëjnë përpjekje për të ndihmuar fuqizimin e grave dhe arritjen e barazisë gjinore përmes programeve GEWE, dhe objektivi i pestë i zhvillimit të qëndrueshëm (SDG)¹⁶ është fokusuar veçanërisht te barazia gjinore.. Rëndësia e kësaj

çështjeje shihet qartë në faktin që temat gjinore janë ndërthuren nëpër pothuajse të gjitha objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm (objektivat 1, 2, 3, 4, 6, 7, 8, 10, 11, 16, dhe 17 përmbajnë dimensionin gjinor) ([UNWOMEN, 2015](#)). Arsimi shihet si një fushë brenda së cilës duhet të punojmë veçanërisht për arritjen e këtij objektivi sepse ai përfaqëson burimin e resurseve, pavarësisë dhe dinjitetit. Duhet të punojmë për mundësi të barabarta në arsim, trajtim të barabartë në tregun e punës, çrrënjosje të dhunës gjinore etj.

Pritjet shoqërore dhe stereotipat për rolet gjinore mund të ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme tek zgjedhja e programit arsimor dhe orientimi në karrierë, shpesh herë duke i bërë të rinjtë që të heqin dorë nga profesionet e caktuara. Këto paragjykime mund të kufizojnë opsionet e djemve dhe vajzave, duke i kufizuar te programet arsimore që ndoshta nuk ofrojnë kaq shumë mundësi profesionale. Kjo shihet qartë nëse ata orientohen drejt karrierave që tradicionalisht konsiderohen si punë "grash" apo "burrash" ([Lange et al., 2020](#)).

Ka shumë paragjykime se kush i bën më mirë profesionet e caktuara. Kështu kemi një ide që vajzat nuk mund të drejtojnë ose riparojnë mirë makineri të ndryshme, dhe që djemtë nuk mund të jenë të mirë në ofrimin e shërbimeve të lidhura me zbulimin - manikyr, pedikyr, parukier etj. Si profesionet e grave konsiderohen ato që lidhen me rolet tradicionale të gruas që shfaqen përmes përkujdesjes dhe kujdesit, ndërsa profesionet e burrave janë ato që kërkojnë forcë, të menduarit racional dhe autoritet. Gjatë shekullit të fundit është bërë e evidente që stereotipat po shpërbëhen dhe se mund të shohim gjithnjë e më shumë gra që drejtojnë autobusa, tramvaje, traktorë, kombajnë, gra inxhinierë, gjithnjë e më shpesh në pozita drejtuese në kompanitë ose në politikë, por dhe gjithnjë e më shumë burra parukierë, kujdestarë etj. Në fakt shumica e

¹⁶ <https://www.un.org/sustainabledevelopment/gender-equality/> e qasur më 10.6.2023.

profesioneve nuk konsiderohen më si të burrave ose të grave, por ato ushtrohen nga personat profesionistë, pavarësisht nga gjinia. Zhvillimi i teknologjive bëri që shumë profesione të mos jenë më të vështira fizikisht, siç ishin në të kaluarën, dhe tani kërkojnë njohuri dhe shkathtësi dhe jo domosdoshmërisht forcë fizike në mënyrë që të kryhen siç duhet.



Burim i fotografisë: [freepik](#)

Edhe pse sot disa profesione, si ai i teknikut bujqësor, mbizotërohen nga burrat, është e domosdoshme të ndërjegjësohemi për barazinë gjinore sepse jetojmë në një shoqëri demokratike të qytetarëve dhe qytetareve të barabarta, dhe në punë hasim edhe burra edhe gra.

Termet kryesore

Seksi Seksi nënkupton karakteristikat biologjike të personit në bazë të të cilave i ndajmë njerëzit në burra dhe gra.

Gjinia u referohet karakteristikave shoqërore dhe kulturore të lidhura me burrat, gratë dhe personat jo-binarë. Gjinia përdoret për të përshkruar pritjet nga pikëpamja e sjelljes, komunikimit dhe ndërveprimeve të njerëzve, bazuar në rolet gjinore.


Rolet gjinore u referohen pritjeve nga individi në varësi nga gjinia e tyre. Ato dallojnë anembanë botës dhe mënyrat se si shprehen ato varen nga kultura dhe shoqëria, dhe mund të ndryshohen me kalimin e kohës. Rolet gjinore mund të jenë *egalitare*, si në rastin kur nuk ka dallime midis asaj që duhet të bëjnë burrat ose gratë, mund të shihen si *komplementare* ku njëra gjini do të bëjë disa role dhe tjetra gjini rolet e tjera, por që midis tyre nuk ka dallim në prestigj dhe pushtet, dhe mund të jenë *asimetrike* si në rastin kur kemi dallime në role dhe kur ato ndiqen nga dallimet në pushtet, prestigj dhe status.

Pabarazia gjinore Pabarazia gjinore i referohet trajtimit ose perceptimit jo të barabartë të individëve në bazë të gjinisë së tyre. Ajo mund të manifestohet në shumë mënyra të ndryshme si diskriminimi, paragjykimet, dhuna dhe qasja jo e barabartë në resurse dhe mundësi në jetë. Pabarazia gjinore bazohet mbi pritje të ndryshme të lidhura me gjininë, që mund të çojë në diskriminim të atyre që nuk u përmbahen këtyre normave.

Stereotipat gjinore janë ide ose paragjyime të thjeshtuara mbi karakteristikat e burrave dhe grave. Është stereotip që djemtë për nga natyra bëjnë shumë zhurmë dhe nuk janë të dëgjueshëm, kurse vajzat janë të urta dhe të sjellshme. Është gjithashtu stereotip që vajzat kanë aftësi më të mira të komunikimit dhe që marrin notat më të mira nga gjuha dhe arti dhe se djemtë janë më racionalë dhe më të mirë në shkencat teknike dhe natyrore. Është e rëndësishme të identifikohen stereotipat dhe që individët me shumë mundësi nuk do të përshtaten me kallëpe të tilla. Çdo person është unik dhe duhet trajtuar si i tillë, dhe të mos gjykohet ose trajtohet ndryshe në bazë të seksit (Malti-Douglas, 2007).

Pse është e rëndësishme të theksojmë lidhjen midis profesionit të bujqësisë dhe gjinisë?

Sepse nëse e kuptojmë se çfarë lidhje ka barazia gjinore dhe prodhimi i qëndrueshëm, mund të dimë se si të përmirësojmë prodhimin bujqësor, të zvogëlojmë risqet dhe ta bëjmë jetën më të mirë për të gjithë ([World Bank, 2009](#)).



Resurset Në mënyrë që shoqëria të jetë e qëndrueshme në mënyrë afatgjatë, individët duhet të kenë qasje në llojet e ndryshme të resurseve, duke përfshirë resurset shoqërore, natyrore dhe financiare. Qëllimi i të gjithëve duhet të jetë shpërndarja sa më e drejtë e resurseve midis grupeve shoqërore, dhe sa më e barabartë midis burrave dhe grave. Për shembull, në vendet ballkanike shumica e tokës së punueshme është në pronë të burrave, dhe situata është e ngjashme edhe në lidhje me pasuri të patundshme (shtëpi dhe banesa). Fakti që burrat janë pronarë të tokës dhe të pasurive të patundshme, u jep atyre një fuqi akoma më të madhe gjatë menaxhimit të fermës dhe të prodhimit. Megjithatë, ka shumë raste që tregojnë se gratë janë po aq të mira në organizimin dhe zbatimin e prodhimit bujqësor, dhe e vetmja gjë që i pengon që të tregohen si të tilla janë zakonet nga e kaluara ku pronat i trashëgojnë fëmijët meshkuj.

Tregu Tregjet bujqësore, duke përfshirë tregjet e produkteve, shërbimeve, punës, shërbimeve financiare, tokës dhe ujit, janë një burim i rëndësishëm i të ardhurave. Pjesëmarrja në këto tregje shpeshherë varet nga qasja dhe kontrolli i kapitalit, mobiliteti dhe faktorët socio-kulturorë, që mund të çojë në shpërpjesëtime gjinore potenciale në disa fusha. Për shembull, edhe pse gratë

përbëjnë pothuajse gjysmën e punëtorëve të angazhuar në bujqësi, qasja e tyre në resurse është kryesisht marginale. Kanë më pak shanse për të marrë kredi ose subvencione etj.



Rreziqet Rreziqet ndaj individëve dhe komuniteteve mund të vijnë në formë të fatkeqësive natyrore, konflikteve mes njerëzve, epidemive të sëmundjeve njerëzore ose shtazore, pasigurisë së ushqimit dhe çrregullimeve në treg (inflacion, recesion etj.). Faktorët si disponueshmëria e ujit, thatësira, ditët me diell si dhe kushtet e tjera agro-ekologjike dhe gjeografike gjithashtu mund të krijojnë rreziqe.

Nëse popullata është më e varfër, do të preket më shumë nga rreziqet e tilla, kurse më shumë do të preken ata që kanë statusin më të ulët në komunitet - gratë dhe fëmijët. Hulumtimet tregojnë që gratë në botë janë më të ekspozuara ndaj rreziqeve të larta në bujqësi duke marrë parasysh se puna e tyre kryesisht zhvillohet në të hapur (në diell, shi, erë) dhe me një shkallë të ulët mbrojtjeje.

Njohuria dhe organizimi Organizimi i individëve në grupe të ndryshme përbën një strategji të mirë të rritjes së resurseve të komunitetit (*së bashku jemi më të fortë!*) dhe u jep qasje më të mirë në mjetet materiale dhe financiare, treg, informacionet dhe njohuritë e duhura për prodhimin bujqësor dhe vendosjen e produkteve në treg. Shpërpjesëtime gjinore në



lidhje me qasjen në informacione dhe pjesëmarrjen në punën e organizatave, nuk kontribuojnë në shfrytëzimin e potencialit maksimal të të gjithë individëve. Qasja në informacione, duke përfshirë informacionet e tregut, informacionet për rreziqet (për shembull reshjet dhe thatësitrat), për të drejtat (për shembull për subvencione) mund të ndihmojnë burrat dhe gratë që të fitojnë qasje në tregje, të rrisin të ardhurat e tyre dhe të menaxhojnë rreziqet ([World Bank, 2009](#)).

Jeta në klasë - disa këshilla pune

Në vazhdim janë disa mënyra¹⁷ se si mund të shmangni stereotipizimin gjinor në klasë, në rastet që paraqiten më të shpeshta:

1 Përdorni gjuhën neutrale gjinore. Kur është e nevojshme që të bëhet diçka, për shembull të sillët ose të çohet jashtë diçka, thoni „A mund ta çojë jashtë **dikush nga klasa?**“ dhe jo „A ka ndonjë **nxënës / djalë** që ta çojë jashtë këtë?“ Madje edhe në rastet kur puna në fjalë kërkon forcë fizike nuk duhet insistuar për dallimin gjinor. Është e dëshirueshme të përfshini vajzat në aktivitetet e tilla duke i zgjedhur vetë herë pas herë, ose duke i inkurajuar që të përfshihen sa më shumë. Nëse klasa përbëhet vetëm nga djemtë, është e dëshirueshme të përdorni gjuhën neutrale gjinore kur flisni për punët që tradicionalisht përmbajnë komponentin gjinor.



2 Nëse disa aktivitete në klasë kryhen rregullisht nga djemtë, dhe disa të tjera vetëm nga vajzat, duhet të rishqyrtohet se sa e justifikuar është kjo. Nëse djemtë gjatë orës së mësimt janë, për shembull, të detyruar të mbajnë disiplinën në rast të mungesës së shkurtër të mësuesit në klasë, ky rol duhet t’u jepet edhe vajzave në mënyrë alternative. Nëse vajzat

kryesisht janë të përfshira në aktivitetet siç është zbukurimi ose sistemimi i ambienteve të shkollës (për shembull gjatë festave) atëherë edhe djemtë duhet të përfshihen në masë të barabartë. Gjithashtu, rolet udhëheqëse duhet t’u jepen edhe vajzave edhe djemve në mënyrë alternative. Për shembull, nëse klasa është duke zgjedhur përfaqësues për parlamentin e nxënësve, mund t’u sugjeroni një ide që të marrin djemtë dhe vajzat në mënyrë proporcionale. I njëjti parim mund të zbatohet edhe për aktivitetet e tjera *ad hoc* në të cilat zgjidhet lideri/liderja e grupit. Nëse klasa përbëhet vetëm nga djemtë, atëherë mund t’u kujtoni nxënësve herë pas herë që nuk ka dallim midis djemve dhe vajzave nga pikëpamja e aftësisë për të kryer detyrat në fjalë, dhe se parimi i barazisë do të zbatohet sikur të kishte vajza në klasë¹⁸ ([A teacher’s guide](#)).

¹⁷ Shembujt janë frymëzuar dhe bazuar mbi një udhëzues të zhvilluar për nevojat e thyerjes së stereotipave gjinore në shkollë: [A Teacher’s Guide to Gender Sensitivity in the Classroom](#). E aksesueshme në: <https://www.aware.org.sg/wp-content/uploads/Teachers-guide-to-addressing-gender-stereotypes-in-the-classroom.pdf> e qasur më 3.1.2023.

¹⁸ [A Teacher’s Guide to Gender Sensitivity in the Classroom](#). E aksesueshme në: <https://www.aware.org.sg/wp-content/uploads/Teachers-guide-to-addressing-gender-stereotypes-in-the-classroom.pdf> e qasur më 1.5.2023.



Burimi: [UNESCO](#)

ËSHTË E RËNDËSISHME QË KËTO AKTIVITETE TË ZHVILLOHEN PA PËRBUZJE DHE PA TENDENCA PËR TË OFENDUAR DIKË. ËSHTË E DËSHIRUESHME QË AKTIVITETET TË ZHVILLOHEN PA EMOCIONE SHITESË, SI TË GJITHA TË TJERAT. NËSE NXËNËSIT KËRKOJNË SHPJEGIM, MUND T’U THONI SE NË ZHVILLIMIN E TEKNOLOGJIVE DHE TË VLERAVE TË JETËS BASHKËKOHORE NUK KA DALLIM MIDIS GJINIVE NGA PIKËPAMJA E AFTËSIVE OSE PUNËVE QË ATO MUND TË USHTROJNË.

Thyerja e stereotipave gjinore

Sfida më e rëndësishme në thyerjen e stereotipave është gjatë praktikës profesionale.

Janë dy mënyra se si nxënësit mund të mësojnë në këtë proces: 1. Duke kopjuar shembujt pozitiv dhe 2. Duke marrë instruksione nga ana e mësuesit.



Në rastin e parë bëhet fjalë për të mësuarit sipas modelit nga ana mësuesit dhe stafit ndihmës gjatë procesit të zbatimit të praktikës. Prandaj është mirë që shkolla të ketë mësues të të dy gjinive të cilët mund t'u tregojnë nxënësve aktivitetet praktike në mënyrë që nxënësit të shohin se nuk ka dallime gjinore në shpërndarjen e punës, si dhe që burrat dhe gratë mund të bëjnë

pothuajse çdo punë me efikasitet të njëjtë. Autoriteti i mësuesit është me rëndësi kyçe në këtë proces, sepse nëse nxënëset e shohin mësuesen që po drejton traktorin ose ndonjë makineri tjetër, ose nëse nxënësit shohin mësuesin që po mjet lopën, kjo do të krijojë mesazhe të forta dhe modele legjitime të sjelljes. Është e dëshirueshme që shkolla të ketë një politikë të balancuar gjinore të punësimit të stafit ndihmës që merr pjesë në zbatimin e praktikës profesionale. Nuk është mirë nëse të gjithë operatorët e makinerive bujqësore janë burra. Nëse edhe gratë drejtojnë makineritë - traktorët, makina kositëse, freza, kamionë dhe makineri të tjera operative, si dhe nëse burrat bëjnë për shembull punët e pastrimit, përpunimit dhe përgatitjes së ushqimeve, atëherë edhe nxënësit do të kenë modele të dorës së parë. Këto modele do t'u tregojnë se ushtrimi i profesioneve të caktuara nuk do të thotë (vetë)respekt më i ulët, por që ato mund të ushtrohen nga cilido profesionist.

Në rastin tjetër kjo do të thotë që kur mësuesit shpjegojnë se si kryhen punët individuale, të japin instruksionet neutrale gjinore ose të theksojnë se punët në fjalë mund të kryhen po aq mirë si nga burrat ashtu nga gratë.

MBANI MEND - NJË FIGURË FLET SA NJË MIJË FJALË. PRANDAJ BËHUNI MODEL POZITIV PËR NXËNËSIT TUAJ.

MËSUJES BURRA DUHET TË JENË MODEL I VËRTETË PËR DJEMTË DHE TË ZOTËROJNË EMPATINË DHE KUJDESSHMËRINË QË DO T'I NDIHMOJË DJEMTË QË TË PËRVETËSOJNË IDEALE TË REJA E MASKULINITETIT QË PËRFSHIJNË EMPATI, KUJDESIN NDAJ TË TJERËVE, DHEMBSHURINË

Ushtrimi mbi profesionet gjinore

1 Ushtrimi: Gjatë orës mund të nisni diskutim për rolet gjinore në prodhimin bujqësor. Mund të shtroni pyetje për shembull, si bëheshin dikur punët e caktuara në fermë: Lëvrim, mbjellje, korrje, përpunimi i grurit, gatimi i bukës. Pastaj pyetini se si bëhen sot këto punë? Le të vënë re që teknologjia ka avancuar dhe ka lehtësuar punë të ndryshme. Në të kaluarën ato punë ishin pjesë e shpërndarjes së punës sipas gjinisë dhe moshës, ndërsa sot kjo është bërë pothuajse e panevojshme. Pastaj pyetini nëse ndarja e punëve sipas seksit është e justifikuar.

Shembujt nga historia



Përdorimi i shembujve nga e kaluara ose nga kulturat e tjera, që tregojnë ndryshimin e roleve dhe marrëdhënieve gjinore, si dhe mundësitë e ndryshme të barazisë gjinorë, përbën një qasje e cila mundëson identifikimin e ndryshimeve të ideve shoqërore dhe besimeve për burrat, gratë dhe marrëdhëniet e tyre me kalimin e kohës, dhe ndikimin e tyre në shoqëri. Për shembull, gjatë

Revolucionit Industrial në Evropë gjatë shekullit të 19-të, kanë ndodhur ndryshimet që kanë shtuar pabarazinë gjinore. Kur gratë dhe burrat jetonin në fshat, ata kanë qenë të përfshirë pothuajse njësoj në punët e fermës. Shpërndarja e punës bëhej sipas seksit, por rëndësia ekonomike e punës së grave jo rrallë e tejkalonte atë të burrave. Ky fakt i ka dhënë gruas një rëndësi të caktuar, madje edhe në shoqërinë patriarkale. Me industrializimin erdhi ndarja e sferës së amvisërisë dhe sferës së punës. Nuk punohet më në fermë por në fabrikë, gjë që sollti ndarjen e sferës në atë private dhe publike, kështu pra në atë të burrave dhe të grave. Gratë mbeteshin në shtëpi si amvise dhe nëna ndërsa burrat shkonin në punë në fabrikë, duke çuar kështu në thellimin e pabarazisë gjinore në periudhën e parë të industrializimit. Gjysma e dytë e shekullit të 19-të dhe i gjithë shekulli i 20 u shënuan nga lufta për barazinë e të drejtave të burrave dhe grave, dhe për këtë arsye sot kemi shumë shembuj ku shohim që gratë e kanë arritur barazinë. Ligjërata mbi historinë e barazisë gjinore mund të jenë të dobishme për nxënësit, sidomos adoleshentët, që të kuptojnë origjinën e ideve mbi barazinë gjinore të cilat ende ndikojnë në jetën dhe marrëdhëniet e tyre personale. Gjithashtu kjo mund të jetë një mënyrë efikase për mësuesit që të përfshijnë perspektivën e barazisë gjinorë në materialet e orës së mësimi.

Historia na mëson që gratë janë po aq të mira në të gjitha punët të cilat dikur konsideroheshin punë burrash. Gratë janë po aq të mirë si inxhinierë, mësuese, politikane, drejtore, shkencëtare, agronome, veterinerë etj. Për shembull, edhe pse sot gratë mbizotërojnë në profesionet e mësueses dhe kujdestares, në të kaluarën këto profesione u takonin vetëm burrave. Me kalimin

e kohës edhe gratë filluan t'i bënin dhe në një periudhë filluan të mbizotëronin në këtë fushë. Për shkak të pabarazive gjinore, këto profesione të cilat kryesisht ushtrohen nga gratë, filluan të humbnin prestigj dhe lartësinë e pagës. Padrejtësitë e tilla po korrigjohen sot.

Maria Kyri është i vetmi person që ka fituar dy çmime Nobel në dy kategori të ndryshme shkencore - fizikë dhe kimi.

Romani i parë në botë, "Përralla e Genxhit" u botua në Japoni rreth vitit 1000 të erës sonë, nga ana e autores Murasaki Shikibu.

Sot kujdesi shëndetësor u ofrohet pacientëve nga "infirmieret" dhe edhe pse sot është bërë gjë e zakonshme që këto punë i bëjnë gratë, në të kaluarën në fakt, kur sapo ishte krijuar ky profesion, atë e bënin vetëm burrat. Kështu dëshmon Hipokrati se në kohën antike këto punë i bënin vetëm burrat, dhe se ka qenë e njëjta situatë edhe në Indi por edhe në Romën antike, ku ushtarët ofronin kujdesin më të mirë për të sëmurit (Keith Rischer).

A e dinit se këpucët me taka fillimisht visheshin nga burrat?

Ato janë shpikur në shekullin e 15 në Persi, dhe më pas kanë ardhur në Evropë me tregtarët. Aristokracia menjëherë ra në dashuri me to sepse burrat dukeshin më të gjatë kur i vishnin. Më pas filluan t'i vishnin edhe gratë, ndërkohë që kanë dalë nga "moda" tek burrat.



Ushtrimi - Ora me kujdestarin e klasës

Të paktën një orë në vit me kujdestarin e klasës duhet t'u kushtohet temave gjinore. Gjatë kësaj ore mësuesi mund të shtrojë tre qëllime të lidhura:

1 Prezantimi / kujtimi i nxënësve mbi seksin, gjininë, rolet gjinore, pabarazitë gjinore dhe stereotipat gjinore.

2 Identifikimi i përbashkët i pabarazive gjinore dhe/ose diskriminimit gjinor në shoqëri, por edhe në shkollë midis nxënësve dhe midis nxënësve dhe mësuesve. Mund t'i ndani nxënësit në grupe më të vogla (nga 5-6 nxënës) dhe t'u jepni detyrë të njëjtë dhe 10 minuta kohë që ta diskutojnë bashkë. Detyra mund të ketë tre pyetje: 1 Ku mund të identifikoni pabarazitë ose stereotipat gjinore në shoqërinë rreth jush? 2 A mund të identifikoni pabarazitë ose stereotipat gjinore në shkollë midis nxënësve? 3 A shfaqin mësuesit pabarazitë ose stereotipat gjinore me njëri-tjetrin ose ndaj nxënësve? Më pas çdo grup duhet të raportojë shkurtimisht mbi shqyrtimet e tyre, dhe më pas vijon debat i përbashkët me mësuesin. Mësuesi duhet të udhëheqë debatin duke nxitur nxënësit që të rishqyrtojnë se sa të justifikuara janë praktikat e tilla.

3 Identifikimi i shembujve të praktikës së mirë të barazisë gjinore. Qëllimi i kësaj pjese të punëtorisë është që nxënësit të japin shembuj ku shihet që gratë kanë arritur të fitojnë fushëveprime ose profesione të cilat tradicionalisht u kanë takuar burrave, ose ku burrat janë treguar të mirë në profesionet tradicionale të grave. Mund të fokusoheni te shembujt nga prodhimi bujqësor dhe organizimi i amvisërisë ([Gačanica et al., 2020](#)).

Nëse shkolla ka parlamentin e nxënësve, atëherë në këtë nivel mund të formohet një organ i veçantë i cili mund të kontaktohet nëse dikush nga nxënësit ose nxënëset dëshiron të paraqesë ankesë për trajtim të papërshtatshëm, nga ana e nxënësve ose mësuesve, në lidhje me seksin.



Stereotipat gjinor nuk funksionojnë vetëm ndaj pjesëtarëve të gjinisë tjetër. Ato përbëjnë paragjykime edhe për gjininë e vetë dhe përfshijnë standardet se si duhet të sillen një djalë ose vajzë. Nëse dikush nuk u përmbahet standardeve të gjinisë së vetë, ai mund të pësojë diskriminim dhe dhunë. Pra, nëse një djalë nuk është mjaftë mashkullor, ose “burrë” i vërtetë, gjë që përfshin dhe trup atletik, të

jetë i fort, i shkathët, ambicioz, atëherë ai mund t'i nënshtrohet përbuzjes dhe izolimit shoqëror, ndonjëherë edhe diskriminimit dhe dhunës nga bashkëmoshatarët. Të njëjtën situatë kemi edhe me vajzat të cilat konsiderohen jo mjaft “femërore” që nënkupton të jenë të bukura, të kenë shije për veshje dhe paraqitje. Ato që nuk përshtaten në këto “standarde” mund të diskriminohen. Prandaj është e rëndësishme të thyejmë stereotipat dhe të lejojmë mënyrat e ndryshme të shfaqjes së personalitetit (në fund të fundit edhe të të qenit mashkullor dhe femërore) Mësuesi

duhet të parashtrijë vlerat universale të cilat duhet t'i udhëheqin nxënësit, siç është nderi, njohuritë, empatia, aftësi sociale etj.

Gjinia dhe dhuna në shkollë



Periudha e adoleshencës është shumë sfiduese si për djemtë ashtu dhe për vajzat, dhe presioni për t'u bërë konform grupit ose për t'u treguar para tjerëve mund të jetë tepër i madh. Prapë se prapë, duhet të kujdesemi që të mos kalohen disa kufij dhe të mos lejohet sjellja e papërshtatshme ndaj bashkëmoshatarëve.

Çka është dhuna? Edhe pse është përhapur mendimi se vetëm forma fizike e dhunës quhet

dhunë, bëhet fjalë për një fenomen që ka shumë fytyra të ndryshme. Mund të dallojmë format në vijim:

1. **Kontaktet fizike** që përfshijnë forma të ndryshme të goditjeve (shuplak, grusht etj.), shkulje flokësh, shtyrje, mbytje ose kufizim lëvizjeje. Kjo formë e dhunës është disi më e shpeshtë tek djemtë, por mund të ndodhë si në klasë, ashtu dhe pas shkollës mes bashkëmoshatarëve. Shenjat që duhet të ngrenë shqetësim tek mësuesit janë të nxirat, lëndimet e dukshme, gërvishtje, por edhe sjellja e tërhequr dhe paraqitja e shqetësuar të nxënësit.
2. **Ngacmimi seksual** që përfshin të gjitha veprimet me kuptim seksual që nuk nënkupton pëlqimin e të dy personave të përfshirë: Nga komentet e papërshtatshme, prekjet, deri tek akti seksual pa pëlqim.
3. **Ngacmimi psikologjik** nënkupton shantazh, poshtërim, stigmatizim, izolim shoqëror, frikësim etj. Ky lloj ngacmimi po bëhet gjithnjë e më i pranishëm tek adoleshentët si stigmatizim i disa fëmijëve dhe përjashtimi i tyre nga ambienti i përbashkët. Zhvillimi i internetit dhe të rrjeteve sociale ka shtuar risqet nga ngacmimi psikologjik.
4. **Dhuna ekonomike** përfshin tjetërsim ose kufizim kontrolli mbi mjetet financiare dhe materiale. Ndër adoleshentë kjo mund të shfaqet në formë të OTIMANJA të parave ose sendeve të tjera me vlerë (rroba, këpucë, orë, telefona, aksesore shkolle etj.) më shpesh nga ana e nxënësve më të mëdhenj.
5. **Ngacmimi dixhital** i referohet keqpërdorimit të teknologjive dixhitale (internet, rrjetet sociale) me qëllim për t'i bërë keq personit tjetër. Disponueshmëria e teknologjive dixhitale dhe mungesa e rregullimit të përdorimit të tyre, çon në përdorimin e tyre në klasë (dhe jashtë saj) me qëllim të stigmatizimit ose përbuzjes së të tjerëve.

Rekomandim për mësuesit dhe administratën e shkollës:¹⁹

1. **Shkolla duhet të krijojë dhe të promovojë atmosferën e sigurisë dhe mirëbesimit për të gjithë nxënësit.** Shërbimet profesionale në shkollë (pedagog, psikolog, zyra e këshillimit) duhet të kenë programe me të cilat punojnë për parandalimin dhe përgjigjen ndaj dhunës.²⁰ Kjo mund të përfshijë vlerësimin e shkollës për shkallën dhe format e riskut nga dhuna, formimin e rrjetit të brendshëm të mbrojtjes (mësuesit, shërbime profesionale, nxënësit), formimin e rrjetit të jashtëm të mbrojtjes (mbështetja institucionale: Poliklinika, Qendra për Punë Sociale, organizata joqeveritare etj.) dhe ndërgjegjësimin për risqet me nxënës, mësues dhe prindër.
2. **Vendosja e standardeve të qarta të sjelljes dhe të pasojave për tejkalim kufijsh** Toleranca për cilëndo formë të dhunës nuk duhet të ekzistojë, por pasojat e mosrespektimit të këtij standardi duhet të jenë në përputhje me shkeljen në fjalë. Është mirë që nxënësit të përfshihen në diskutime për këto çështje si dhe në procesin e miratimit të rregulloreve dhe standardeve që rregullojnë këtë fushë.
3. **Inkurajimi i nxënësve që të raportojnë në kohë rastet e incidenteve të mësuesit dhe shërbimet profesionale.** Për këtë arsye është e domosdoshme që të kemi procedura të sigurta si dhe atmosferë mbështetëse (si të mësuesve ashtu dhe të bashkëmoshatarëve) që ulin riskun nga përjashtimi dhe stigmatizimi të atyre që raportojnë.
4. **Zbulimi i hershëm i shenjave të ngacmimit dhe dhunës** Nxënësit, mësuesit dhe prindërit duhet të sensibilizohen që të vënë re shenjat e hershme të formave të ndryshme të ngacmimit dhe t'u përgjigjen në mënyrë të përshtatshme.
5. Ata që përjetojnë forma të ndryshme të dhunës (ose kanë pësuar trauma për shkak të ekspozimit) duhet të kenë mundësi që të kërkojnë ndihmë dhe mbështetje nga shërbimet profesionale, përmes kanaleve të sigurta që garantojnë anonimitet. Nëse shkolla nuk ka kapacitete të mjaftueshme profesionale atëherë mund të krijojë bashkëpunim me ndonjë organizatë e cila ofron këtë lloj mbështetjeje në nivelin lokal ose kombëtar.
6. **Inkurajimi i nxënësve që të marrin përsipër një pjesë të përgjegjësisë për sigurinë në klasë dhe në shkollë.** Kjo i referohet përgjegjësisë për veprimet e veta, por edhe përgjegjësisë për të tjerët dhe klasën. Klasa si tërësi mund të bisedojë (për shembull gjatë orës me kujdestarin e klasës) për sfidat që hasin dhe mund të vendosin procedura se si duhet reaguari në rastet kur ndodh ngacmimi dhe dhuna.
7. **Inkurajimi i prindërve që të bisedojnë rregullisht me fëmijët e tyre për risqet dhe të promovojnë kulturën e jodhunës.** Prindërit janë aleatë të parë dhe më të rëndësishëm

¹⁹ E aksesueshme në: <https://www.nasponline.org/resources-and-publications/resources-and-podcasts/school-safety-and-crisis/school-violence-resources/school-violence-prevention> e qasur më 10.6.2023.

²⁰ E aksesueshme në: <http://sbn.mpn.gov.rs/o-skoli-bez-nasilja/o-programu-4046> e qasur më 10.6.2023.

në këtë angazhim të përbashkët. Gjatë takimeve me prindërit, tema e veçantë duhet të jetë e lidhur me risqet nga dhuna dhe ngacmimi në klasë dhe jashtë saj. Të ndihmojmë prindërit që të identifikojnë sjellje të papërshtatshme të fëmijëve të tyre, ose të dallojnë BEZAZLEN NESTASLUK nga sjellja që mund t'i bëjë keq fëmijës tjetër, dhe t'i ndihmojmë që të reagojnë në mënyrë të përshtatshme. Zgjidhja më e mirë është kur prindërit, fëmijët, mësuesit dhe shërbimet profesionale (të shkollës) punojnë bashkë në një atmosferë mirëbesimi.

8. **Vini re aspektet fizike të sigurisë së shkollës:** Mbyllje dyersh, hyrja e personave të rritur, qëndrimi i fëmijëve që s'janë nxënës të shkollës në oborrin e shkollës etj.
9. **Gjinia dhe dhuna:** Të gjitha format e lartpërmendura të dhunës mund të manifestohen edhe si ngacmim gjinor ose si dhunë nga bashkëmoshatarët. Ajo mund të shfaqet edhe si ngacmim ndaj vajzave, dhe më shpesh përfshin dhe disa nga format e dhunës seksuale. Homofobia dhe diskriminimi i popullatës LGBTQ+ është një formë tjetër e pranishme e dhunës gjinore ndër adoleshentë.²¹ Prandaj është e domosdoshme që të kemi kujdes të veçantë nëse personat e rrezikuar (vajza, pjesëtar të komunitetit LGBTQ+) pësojnë ndonjë formë dhune në klasë ose jashtë saj.

²¹ E aksesueshme në: <https://www.unicef.org/documents/global-guidance-addressing-school-related-gender-based-violence> e qasur më 5.6.2023.

Këshillat gjatë zbatimit të mësimit për zvogëlimin e stereotipave gjinor dhe përjashtimit social²²

1 Zgjedhja e nxënësit që do t'u përgjigjet pyetjeve

Gjatë përzgjedhjes së nxënësit që do t'u përgjigjet pyetjeve të mësuesve, është e rëndësishme të kemi parasysh që më shpesh do marrin fjalën nxënësit ekstrovert, nxënës më të mirë (dhe nxënësit më të mirë zakonisht vijnë nga familjet ku prindërit janë me arsim të lartë), dhe se për temat e caktuara më shpesh do të përgjigjen djemtë dhe për temat e tjera vajzat. Për këtë arsye, mësuesit mund të favorizojnë disa nxënës gjatë diskutimeve në klasë, duke çuar kështu në përfshirje të disave, dhe në përjashtim të disave të tjerë nga diskutimet. Është mirë që mësuesi të përfshijë të gjithë nxënësit, pavarësisht temës, notave të tyre ose seksit. Për shembull nëse në orën e gjuhës amtare duhet të lexohet një tekst, mund të vendosni një rregull që ta lexojë ai nxënës që ka ditëlindjen më shpejt, ose ndonjë rregull tjetër të ngjashëm. Ose gjatë shpjegimit të mënyrës së funksionimit të motorit me djegie të brendshme në orën e mekanizimit bujqësor, duhet të përfshijmë edhe vajzat në masë të barabartë. Gjatë zbatimit të mësimit praktik duhet të kujdesemi në veçanti që të përfshijmë njësoj të gjithë nxënësit në të gjitha aspektet e mësimit praktik, si djem, ashtu dhe vajza, si ata me nota të larta, ashtu dhe me të ulëta.

2 Feedback nga mësuesi

Feedback i mësuesit ndaj përgjigjeve, detyrave ose aktiviteteve të nxënësve duhet të jenë neutrale nga aspekti gjinor dhe social. Para se t'i jepni feedback një nxënësi, mendohuni nëse përgjigja juaj do të ishte e njëjtë sikur të bëhej fjalë për një nxënës të seksit të kundërt, ose me prindër me arsim të lartë / të ulët, ose nxënës nga pakica / shumica etnike. Nëse përgjigja është jo, atëherë provoni të riformuloni përgjigjen tuaj. Rekomandohet që të mendoni për format e reagimeve tuaja (nga ato pozitive, deri tek negativet) ndaj përgjigjeve të nxënësve dhe që ato të jenë neutrale në raport me gjininë dhe origjinën sociale të fëmijës.

3 Ritmi i orës

Një nga sfidat që hasin mësuesit është sfida e “ecurisë” së orës, përkatësisht të mos ketë humbje kohe dhe të kemi dinamikë të mirë me nxënësit. Kjo do të thotë se kur mësuesi bën pyetje, pritjet përgjigja e shpejtë dhe vazhdimi i leksionit ose diskutimit. Por kjo çon në përfshirje më të shpeshtë të vetëm atyre nxënësve që janë ekstrovertë dhe shumë me shpesh janë djemtë sesa vajzat. Kur bëni pyetje, prisni disa sekonda dhe do të shihni se do të ngrenë dorën më shumë prej tyre. Ju do të përzgjidhni se kush do të përgjigjet. Mos u bëni “presion” që të përfshihen por thoni diçka si “çfarë mendon për këtë filan nxënës...” dhe nëse ai/ajo nuk ka ndonjë mendim për temën

²² Shembujt janë frymëzuar dhe bazuar mbi një udhëzues të zhvilluar për nevojat e thyerjes së stereotipave në shkollë: A Teacher's Guide to Gender Sensitivity in the Classroom: <https://www.keithrn.com/2014/05/the-lost-historical-legacy-of-men-as-caregivers-why-it-still-matters-today/> e qasur më 5.5.2023.

në fjalë, ose ka turp të shprehet, mund të thoni “s’ka gjë, herës tjetër” Duke qenë se janë aktivitetet ku nxënësit nuk pyeten me qëllim të vënies së notës, nuk është e domosdoshme që të dinë përgjigjet, por vetëm të përfshihen dhe të shprehin mendimin e tyre, dhe kurrë nuk duhet të ndihen keq. Përpikuni të përfshini sa më shumë nxënës, sepse kur marrin guximin për të thënë diçka, kjo i inkurajon më vonë që të përfshihen vetë. Nëse dikush është i tërhequr si karakter, është e nevojshme që t’i afroheni dhe të bisedoni me të pas mësimin në lidhje me mendimin e tij/saj për temën në fjalë, dhe eventualisht mund ta lavdëroni në orën e ardhshme. Gjithashtu, mund t’u jepni opsion nxënësve që t’ju shkruajnë mendimin e tyre për një temë të caktuar mbi një copë letër, dhe t’jua dorëzojnë atë gjatë ose pas mësimin.

4 Menaxhimi i klasës

Shumica e mësuesve herë pas here hasin nënvlerësim të autoritetit të tyre. Sfidimi i autoritetit është sjellje e shpeshtë tek adoleshentët dhe përbën një pjesë të maturimit dhe autonomizimit të tyre. Ky lloj sjelljeje shfaqet më shpesh tek djemtë sesa tek vajzat. Janë dy aspekte të rëndësishme me qëllim që gjerat të mos dalin nga kontrolli. Së pari, krijoni një marrëdhënie të respektimit dhe vlerësimit reciprok, dhe së dytë, të bini dakord me nxënësit në lidhje me rregullat e sjelljes në klasë që në orën e parë të mësimin. Përcaktoni se cilat praktika nuk do të tolerohen dhe përmbahuni këtyre rregullave gjatë gjithë vitit. Kujtojeni se keni vendosur bashkë parimet e sjelljes dhe se sjellja e papërshtatshme nuk tolerohet nën asnjë lloj preteksti (për shembull se kjo është normale për djemtë). Jini parimor dhe të rreptë në lidhje me rregullat dhe sanksionet.

Njëkohësisht, le ta dinë nxënësit që mund të mbështeten tek ju dhe se kurrë nuk do ta thoni publikisht atë që ju është thënë në mirëbesim (përveç nëse bëhet fjalë për informacionet për të cilat duhet të njoftoni institucionet / policinë, por në këtë rast duhet t’u thoni paraprakisht se cilat informacione jeni të detyruar t’i raportoni). Jini të gatshëm për t’i dëgjuar në mënyrë aktive sepse shumica e adoleshentëve kanë përshtypje se të rriturit nuk marrin seriozisht mendimet e tyre. Gjithashtu, provoni të jeni pozitiv dhe të buzëqeshur.²³

5 Tregoni një gamë të gjerë mundësish që nuk varet nga gjinia.

Në tekstet shkollore gjithashtu mund të identifikohen stereotipat gjinore. Për shembull, në figurat e librave profesionale më shpesh do të shihni burrat që drejtojnë makineritë ose bëjnë detyra komplekse, ndërsa gratë mund të paraqiten duke kryer punë të ndryshme si pastrim, punët e shtëpisë etj. Në raste të tilla merrni shembuj të kundërt dhe shpjegoni se punët e tilla dhe të ngjashme mund të kryhen edhe nga nxënësit e gjinisë së kundërt. Mund të gjeni shembuj nga jeta reale dhe nga e kaluara, për të inkurajuar nxënësit e të dy seksëve që të bëjnë të gjitha detyrat.

6 Privilegjimi është fytyra e dytë e diskriminimit

²³ E aksesueshme në: <https://www.wgu.edu/heyteach/article/Authority-in-the-Classroom-5-Tips-for-Striking-the-Right-Balance1808.html> e qasur më 10.6.2023.



Kini parasysh se privilegjimi është fytyra e dytë e diskriminimit sepse privilegjimi i dikujt do të thotë diskriminimi i dikujt tjetër. Për shembull, nëse nxënësit me nota më të mira ushtrojnë disa aktivitete - si mbajtja e prezantimit në klasë, prezantimet në raste festash ose (mos)kryerja e disa aktiviteteve gjatë praktikës profesionale - mësuesit mund t'u caktojnë aspektet më të vështira dhe më interesante nxënësve më të mirë, ndërsa detyrat teknikisht më të thjeshta mund t'u caktojnë atyre që kanë nota më të ulëta. Të njëjtin "kursim" mund ta marrin edhe vajzat e klasës. Edhe pse mësuesit mund të kenë synime të mira, praktikat e tilla mund të bëhen pak a shumë të përhershme, dhe ata nxënës që kanë notat më të ulëta, që janë deprivilegjuar shpesh në disa mënyra (vijne nga familjet e varfra, prindërit kanë arsim më të ulët dhe nuk mund t'i ndihmojnë shumë në përvetësimin e leksioneve) mbeten të privuar për disa aftësi dhe njohuri të caktuara. Kështu për shembull, djemtë nuk do të mësojnë se si konservohen frutat ose si bëhet marmelata, ndërsa vajzat nuk do të mësojnë se si dhe çfarë vaji përdoret për lubrifikimin e motorit. Kjo gjithashtu mund të çojë në një ndarje tjetër në punë burrash dhe punë grash, ndarje kjo e cila nuk është funksionale sot dhe nuk aftëson një pjesë të mirë të popullatës për detyrat që janë pjesë e rezultateve të të nxënësve.

7 Inkurajoni nxënës joaktiv dhe të tërhequr

Herë pas here inkurajoni me kujdes ata nxënës që përfshihen rrallë në diskutim. Shprehja "Heshtja është flori" tregon që disa persona heshtin jo sepse nuk kanë ç' të thonë, por sepse kështu janë më rehat. Kur u bëni pyetje, provoni të gjeni ndonjë aspekt interesant të përgjigjes së tyre dhe lavdërojeni atë. Ju, si mësues, jeni autoriteti që duhet t'i trajtojë të gjithë nxënësit njësoj dhe t'u ofrojë ndjesinë e dinjitetit dhe vetëvlerësimit. Ndoshta nuk do ta mbajnë mend çdo leksion, por me siguri do ta dinë se cilët mësues i kanë respektuar, frymëzuar dhe zbuluar kohën e kaluar në shkollë mes shokëve.

Ndërlidhja me kolegët dhe bashkëmoshatarët nga vendet e tjera

Një nga mënyrat për të zvogëluar dallimet që ekzistojnë midis shkollave VET dhe shkollave të mesme të përgjithshme është ngritja e kompetencave të mësuesve në sistemin VET. Përveç edukimeve të organizuara në nivelin kombëtar, kemi dhe mundësi ndërkombëtare të shkëmbimit dhe aftësimi si programet ERASMUS+.

Në kuadër të K1 ERASMUS+ kemi një program të veçantë [24 për mobilitetin e nxënësve dhe mësuesve në sistemin VET](#). Institucionet që ofrojnë arsim profesional, si dhe organizatat e tjera aktive në këtë fushë, mund të aplikojnë për mbështetje financiare në dy mënyra:

1. Për mbështetjen e **projekteve afatshkurtra për mobilitetin e nxënësve dhe të stafit**, të cilat mundësojnë organizimin e aktiviteteve të ndryshme të mobilitetit gjatë periudhës nga gjashtë deri në tetëmbëdhjetë muaj dhe janë të dedikuara organizatave të cilat aplikojnë për herë të parë për Erasmus+ ose që duan të organizojnë një numër të kufizuar aktiviteteve,
2. Për mbështetjen e **projekteve të akredituara për mobilitetin e nxënësve dhe të stafit**, që janë hapur vetëm për organizata me akreditim të Erasmus-it në fushën e arsimit të mesëm profesional (VET) dhe mundësojnë marrje të rregullt të mbështetjes financiare për programet. Organizatat mund t'i bashkohen programit pa aplikuar, duke iu bashkuar konsorciumit ekzistues Erasmus+ të mobilitetit që udhëhiqet nga koordinatori i akredituar të konsorciumit që pranon anëtarë të rinj, si dhe pjesëmarrës të ftuar nga vendet e tjera.

Një tjetër program i rëndësishëm në nivelin evropian është [eTwinning²⁵](#), [eTwinning²⁶](#) u mundëson mësuesve dhe nxënësve që të punojnë bashkë dhe të frymëzohen nga puna e kolegëve të tyre nga vendet e tjera në kuadër të programit Erasmus+ përmes projekteve dhe aktiviteteve të përbashkëta, qoftë me prani fizike, qoftë online. [TwinSpace²⁷](#) është një platformë që ofroni mbështetje për këto aktivitete. eTwinnerat mund të ndërlidhen dhe të bashkëpunojnë me eTwinnera dhe shkollat e tjera duke përdorur funksionet e ndryshme të rrjeteve sociale, si dhe duke marrë pjesë në **dhoma** (rooms), **grupet eTwinning dhe projektet evropiane**. **Dhomat** (rooms) janë mikro-grupe që mundësojnë video-konferenca, forume dhe arkivin e të dhënave. **Grupet eTwinning** janë vendet virtuale ku eTwinnerat bisedojnë për temat specifike dhe fushat e interesit. **Projektet eTwinning** përfshijnë aktivitetet dhe zhvillimin e kompetencave me dy ose më shumë mësues dhe nxënës të tyre. eTwinnerat gjithashtu mund të marrin pjesë dhe në ngjarjet

²⁴ E aksesueshme në: <https://erasmus-plus.ec.europa.eu/programme-guide/part-b/key-action-1/mobility-vet> e qasur më 24.12.2022.

²⁵ E aksesueshme në: <https://www.youtube.com/watch?v=jpmUYAaKHso> e qasur më 24.12.2022.

²⁶ E aksesueshme në: <https://school-education.ec.europa.eu/en/etwinning> e qasur më 24.12.2022.

²⁷ E aksesueshme në: <https://twinspace.etwinning.net/about> e qasur më 24.12.2022.



online që janë të rëndësishme për zhvillimin e kompetencave, siç janë kurse të shkurtra, webinarë, dhe ngjarje dhe konferenca online, të organizuara nga Platforma Evropiane e Arsimit.

Për të marrë më shumë informacione mbi programet dhe mundësitë që ofrohen në to, kontaktoni zyrën e ERASMUS+ [në vendin tuaj](#).²⁸

²⁸ E aksesueshme në: <https://erasmus-plus.ec.europa.eu/contacts/national-agencies> e qasur më 24.12.2022.

Literatura dhe burimet nga interneti

Gaćanica, L. ed. (2022) **Priručnik za integriranje rodne dimenzije u srednje stručno obrazovanje**, Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Sarajevo, e aksesueshme në

https://www.mladi.org/phocadownload/Prirucnik%20za%20integriranje%20rodne%20dimenzije%20u%20srednje%20strucno%20obrazovanje_FINAL_WEB_Septembar%202022.pdf e qasur më 24.2.2023.

Lange R., Hofmann C. & Di Cara, M. (2020) **Guide on making TVET and skills development inclusive for all**, International Labour Organization. e aksesueshme në

https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---ed_emp/---emp_ent/documents/publication/wcms_755869.pdf e qasur më 24.2.2023.

World Bank (2009) **Gender in Agriculture Sourcebook**, e aksesueshme në

<https://openknowledge.worldbank.org/handle/10986/6603> e qasur më 3.1.2023.

UNWOMAN, (2015) *Monitoring Gender Equality and the Empowerment of Women and Girls in the 2030 Agenda for Sustainable Development: Opportunities and Challenges*, UNWOMAN.

Austrian Development Agency (2018) **Manual Environmental, Gender and Social Impact Management**

https://www.entwicklung.at/fileadmin/user_upload/Dokumente/Publikationen/Handbuecher/Environmental_and_Social_Impact_Management/EGSIM_Manual_Juni2018.pdf e qasur më 11.1.2023.

A Teacher's Guide to Gender Sensitivity in the Classroom, e aksesueshme në:

<https://www.aware.org.sg/wp-content/uploads/Teachers-guide-to-addressing-gender-stereotypes-in-the-classroom.pdf> e qasur më 3.1.2023.

Building TVET resilience for a just and sustainable transition

<https://unevoc.unesco.org/home/Building+TVET+resilience+for+a+just+and+sustainable+transition> e qasur më 26.12.2022.

The History of High Heels: 10 Facts That Surprise You <https://burjushoes.com/blog/the-history-of-high-heels-10-facts-that-surprise-you/> e qasur më 26.12.2022.

58 team building activities to bring your team together (and have fun!)

<https://www.sessionlab.com/blog/team-building-activities/> e qasur më 26.12.2022.

7 Time Management Training Activities That Will Engage Learners

<https://symondsresearch.com/time-management-activities/> e qasur më 26.12.2022.

Mobility for learners and staff in vocational education and training <https://erasmus-plus.ec.europa.eu/programme-guide/part-b/key-action-1/mobility-vet> e qasur më 24.12.2022.

eTwinning overview <https://school-education.ec.europa.eu/en/etwinning> e qasur më 24.12.2022.

What is the TwinSpace? <https://twinspace.etwinning.net/about> e qasur më 24.12.2022.

Erasmus+ National Agencies <https://erasmus-plus.ec.europa.eu/contacts/national-agencies> e qasur më 24.12.2022.



EQET SEE Occupation standards <https://eget.erisee.org/occupational-standards/> e qasur më 11.1.2023.

eTwinning in VET (English) <https://www.youtube.com/watch?v=jpmUYAaKHso> e qasur më 24.12.2022.

Strength Building exercise <https://www.sessionlab.com/methods/strength-building-exercise> e qasur më 26.12.2022.

Conflict Responses <https://www.sessionlab.com/methods/conflict-responses> e qasur më 26.12.2022.

The Lost Historical Legacy of Men as Caregivers & Why it Still Matters Today
<https://www.keithrn.com/2014/05/the-lost-historical-legacy-of-men-as-caregivers-why-it-still-matters-today/> e qasur më 3.1.2023.

Environmental Equity Vs. Environmental Justice: What's the Difference?
<https://www.mobilizegreen.org/blog/2018/9/30/environmental-equity-vs-environmental-justice-whats-the-difference> e qasur më 28.12.2022.



9 788690 261680